

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Paisje Tik” ndarë në 2(dy) lote

Loti 1: “Blerje Paisje elektronike”

Loti 2: “Blerje Paisje teknologjike per zyrën Flagship”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30124500-9;
30123300-8; 302140000-2; 30231320-6; 30232110-8; 3023724-3; 32340000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: 33,614,518 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) **Lekë (pa TVSH)** ose **358,861** (treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) **Euro**

- **Loti 1 “Blerje Paisje elektronike”: 29,568,018** (njëzet e nëntë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëmbëdhjetë) **lekë pa tvsh** ose **315,662** (treqind e pesëmbëdhjetë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) **Euro**
- **Loti 2: “Blerje Paisje teknologjike per zyren Flagship”: 4,046,500** (katër milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) **lekë pa tvsh** ose **43,200** (dyzet e tre mijë e dyqind) **Euro**

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes te Shqiperise datë 23.07.2026 është 93.67

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

LOTI 1: “BLERJE PAISJE ELEKTRONIKE”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 27001:2022** (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO/IEC 20000:2018** (ose i përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes.

Argumentim: Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023,2024,2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Autorizimi i prodhuesit përbën një dokument thelbësor, pasi përveçse dëshmon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve apo licencave të kërkuara në procedurë, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin e tyre pranë Autoritetit Kontraktor. Kjo garanci lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e produkteve/shërbimeve të kërkuara, të cilat duhet të jenë të prodhuara ose të zhvilluara sipas standardeve më të larta nga prodhues me reputacion ndërkombëtar dhe të njohur në praktikën e tyre tregtare.

Ky kriter nuk është diskriminues, por është në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës, duke u lidhur ngushtësisht me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik në aspektin e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Kërkesa i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar kapacitetet tekniko-profesionale të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se ai disponon autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, shërbimeve apo licencave objekt kontrate, të lëshuara nga prodhuesit ose distributorët zyrtarë.

Në këtë mënyrë sigurohet jo vetëm ligjshmëria e zinxhirit të furnizimit, por edhe vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, përmes bashkëpunimit me të njëjtët prodhues apo struktura të autorizuar të tyre.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohej se në momentin e dorëzimit malli do të shoqërohet me certifikatë origjine dhe certifikatë konformiteti për standardet Europiane, ekuivalente të CE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar dhe sipas standardeve Europiane. Nisur nga rëndësia dhe volumi i kontratës, është e rëndësishme për realizimin me sukses të kontratës, që pajisjet e ofertuara të plotësojnë standardet, duke u shoqëruar nga certifikata e konformitetit për standardet Europiane, ekuivalente të CE. Certifikata e origjinës garanton se produktet e ofertuara do të hyjnë në rrugë zyrtare në Shqipëri.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar, bazuar në pikën 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri garanton që produktet e ofertuara plotësojnë standardet teknike dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen me sukses të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar se pajisjet e ofertuara (Kompjuter, Laptop) do të jenë me sistem OEM sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar, bazuar në pikën 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri garanton që produktet e ofertuara plotësojnë standardet teknike dhe cilësinë e nevojshme për përmbushjen me sukses të kontratës. Gjithashtu ky kriter garanton rrugën zyrtare të licensimit.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për pajisjet që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme modelin e pajisjeve që po oferton dhe specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike (të nënvizuara) të pajisjeve që janë objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat

teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të pajisjeve dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre. Në çdo rast Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të katalogëve për vërtetësinë e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht”... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

LOTI 2 “BLERJE PAISJE TEKNOLOGJIKE PER ZYREN FLAGSHIP”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- 4. 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
- 5.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 27001:2022** (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO/IEC 20000:2018** (ose i perditesuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes.

Argumentim: Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **(2023, 2024, 2025)**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023,2024,2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës**

së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e vlerës jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1. Autorizimi i prodhuesit përbën një dokument thelbësor, pasi përveçse dëshmon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve apo licencave të kërkuara në procedurë, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin e tyre pranë Autoritetit Kontraktor. Kjo garanci lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e produkteve/shërbimeve të kërkuara, të cilat duhet të jenë të prodhuara ose të zhvilluara sipas standardeve më të larta nga prodhues me reputacion ndërkombëtar dhe të njohur në praktikën e tyre tregtare. Ky kriter nuk është diskriminues, por është në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës, duke u lidhur ngushtësisht me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik në aspektin e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Kërkesa i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar kapacitetet tekniko-profesionale të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se ai disponon autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, shërbimeve apo licencave objekt kontrate, të lëshuara nga prodhuesit ose distributorët zyrtarë. Në këtë mënyrë sigurohet jo vetëm ligjshmëria e zinxhirit të furnizimit, por edhe vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, përmes bashkëpunimit me të njëjtët prodhues apo struktura të autorizuar të tyre. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohej se në momentin e dorëzimit malli do të shoqërohet me certifikatë origjine dhe certifikatë konformiteti për standardet Europiane, ekuivalente të CE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar dhe sipas

standardeve Europiane. Nisur nga rëndësia dhe volumi i kontratës, është e rëndësishme për realizimin me sukses të kontratës, që pajisjet e ofertuara të plotësojnë standardet, duke u shoqëruar nga certifikata e konformitetit për standardet Europiane, ekuivalente të CE. Certifikata e origjinës garanton se produktet e ofertuara do të hyjnë në rrugë zyrtare në Shqipëri.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar, bazuar në pikën 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri garanton që produktet e ofertuara plotësojnë standardet teknike dhe cilësinë e nevojshme për kryerjen me sukses të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar se pajisjet e ofertuara (Kompjuter, Laptop) do të jenë me sistem OEM sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar, bazuar në pikën 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri garanton që produktet e ofertuara plotësojnë standardet teknike dhe cilësinë e nevojshme për përbushjen me sukses të kontratës. Gjithashtu ky kriter garanton rrugën zyrtare të licensimit.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për pajisjet që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme modelin e pajisjeve që po oferton dhe specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike (të nënvizuara) të pajisjeve që janë objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të pajisjeve dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre. Në çdo rast Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të katalogëve për vërtetësinë e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht”... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 24.08.2026; Ora: 11:00; Vendi:

“IdentiTek” Sh.A, Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.

